



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datën **10.05.2024**, Nr. **79** Regj.Themeltar, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve: **Arben Lena, Nikolla Hafësllari, Nikolla Jesku, Dajana Kodra (Ninga), Blerand Kozici, Dritan Tabaku, Artiana Kozici.**
2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Erjon Çela, Irena Gjoka dhe Erjon Bani, mbështetur në nenet 39, 59, 245/1 parag. 2 dhe 4 dhe 300 të K.Penal, nenet 190, 403 – 406, 393 dhe 485 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **41**, datë 27.06.2024 vendosi:
  1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arben Lena**, për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 4 e 25 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 3 (tre) vjet burgim.
  2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Arben Lena me 2 (dy) vite burgim.
  3. Vuajtja e dënimit për të pandehurin Arben Lena do të fillojë nga dita që ndaj tij është zbatuar masa e sigurimit personal “*Arrest në burg*” dt. 27.01.2024 dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
  4. Në aplikim të nenit 39 të K.Penal, heqjen e të drejtës për të ushtruar profesionin për të pandehurin Arben Lena për një periudhë kohore prej 3 (tre) vjetësh.
  5. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Nikolla Hafësllari**, për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 2 e 25 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 1 (një) vit dhe 6 (gjashtë) muaj burgim.
  6. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Nikolla Hafësllari me 1 (një) vit burgim.

7. Vuajtja e dënimit për të pandehurin Nikolla Hafësllari do të fillojë nga dita që ndaj tij është zbatuar masa e sigurimit personal “*Arrest në burg*” dt. 26.12.2023 dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
8. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Nikolla Jesku**, për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 2 e 25 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 1 (një) vit dhe 6 (gjashtë) muaj burgim.
9. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Nikolla Jesku me 1 (një) vit burgim.
10. Vuajtja e dënimit për të pandehurin Nikolla Jesku do të fillojë nga dita që ndaj tij është zbatuar masa e sigurimit personal “*Arrest në burg*” dt. 25.12.2023 dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
11. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Dajana Kodra (Ninga)**, për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 4 e 25 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e saj me 2 (dy) vjet burgim.
12. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurën Dajana Kodra (Ninga) me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.
13. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdherohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur të tij duke e vene të pandehurën Dajana Kodra Ninga ne provë për një periudhë kohe prej 2 (dy) vite dhe 8 (tetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale si dhe të mbajë kontakte të rregullta me Zyren e Shërbimit të Provës ku ka vëndbanimin e saj.
14. Në zbatim të nenit 261/1 shkronja “b” të K.Pr.Penale shuarjen e masës së sigurimit personal “*Detyrimi për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore*” e caktuar ndaj të pandehurës Dajana Kodra (Ninga) me vendimin nr. 201 dt. 16.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkalles së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
15. Në aplikim të nenit 39 të K.Penal, heqjen e të drejtës për të ushtruar profesionin për të pandehurën Dajana Kodra (Ninga) për një periudhë kohore prej 1 (një) muaji.
16. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Dritan Tabaku**, për kryerjen e veprës penale “*Moskallëzimi i krimit*”, e parashikuar nga neni 300 i K.Penal, kjo pasi në zbatim të nenit 388/1 shkronja “a” të K.Pr.Penale, fakti nuk ekziston.
17. Në zbatim të nenit 261/1 shkronja “a” dhe nenit 389 të K.Pr.Penale shuarjen e masës së sigurimit personal “*Detyrimi për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore*” e caktuar ndaj të pandehurit Dritan Tabaku me vendimin nr. 137 dt. 25.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkalles së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

18. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Blerand Kozici**, për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 2 e 25 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 2 (dy) vjet burgim.
19. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Blerand Kozici me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.
20. Vuajtja e dënimit për të pandehurin Blerand Kozici do të fillojë nga dita që ndaj tij është zbatuar masa e sigurimit personal “*Arrest në burg*” dt. 25.12.2023 dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
21. Deklarimin fajtores të të pandehurës **Artiana Kozici**, për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 2 e 25 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e saj me 1 (një) vit burgim.
22. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurën Artiana Kozici me 8 (tetë) muaj burgim.
23. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdherohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duke e vënë të pandehurën Artiana Kozici ne provë për një periudhë kohe prej 1 (një) vit dhe 4 (katër) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale si dhe të mbajë kontakte të rregullta me Zyren e Shërbimit të Provës ku ka vëndbanimin e saj.
24. Në zbatim të nenit 261/1 shkronja “b” të K.Pr.Penale shuarjen e masës së sigurimit personal “*Detyrimi për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore*” e caktuar ndaj të pandehurës Artiana Kozici me vendimin nr. 137 dt. 25.12.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkalles së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
25. Në lidhje me provat materiale të sekuestruara për llogari të këtij procedimi penal, gjykata në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale disponon që ato ti kthehen të pandehurve që i takojnë
26. Shpenzimet procedurale të kryera gjatë fazës së hetimit të cilat në bazë të nenit 485/1 të K.Pr.Penale janë parapaguar nga shteti, si dhe shpenzimet gjyqësore t’iu ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidarë, në bazë të neneve 393/1 dhe 406/4 të K.Pr.Penale.
27. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga palët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

**Tiranë, më datë 27.06.2024**

**Gjykata e Posaçme e Shkalles së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**